

Globalizimi dhe Integrimi në BE

Dritan Balla

Institute of European Studies, University of Tirana, Albania

Abstrakt

Kriza e botës bashkëkohore që e ka kapluar globin, është rritur tepër rëndësia e bashkëpunimit ekonomik evropian ndërmjet vendëve antarë e jo vetëm por edhe atyre që janë aspirante. Debatet e (mos) zgjerimit të BE-së vijnë të jenë prezentë në fokusin e politikës së jashtme të Bashkimit Evropian. Por edhe pse këto debate janë ende prezentë në politikën evropiane, sot është e pamundur për të frenuar pasojat e globalizimit në arenën politike ndërkombëtare sidomos aspektin ekonomik. Shtetet janë në krizë nga rrjeti transnacional ekonomik për sa i përket bashkëpunimit ‘*për tej kufijeve*’ dhe rezistenca e kombë-shteteve është në varësi të bashkëpunimit mes shteteve anëtare.

Qasjet politike janë tepër lobuese për sa i përket migrimit të huajve dhe kufizimeve, kriterëve që kanë përcaktuar. Por e ardhmja dhe shpëtimi i Evropës varet nga zgjerimi i saj, sigurisht pasi të jenë përmbushur kriterët e përcaktuara. Globalizimi ka të mirat pozitive dhe negative të tij, si rreziku nga terrorizmi, krimi i organizuar etj., por bashkëpunimi mes shteteve e sidomos rasti i Bashkimit Evropian mund të kontribuojë sadopak në stabilitetin dhe qëndrueshmërinë ekonomike.

Fjalë kyçe: *Shtet, Integrim, Globalizim, BE.*

Hyrje

Europa pas dy luftave të mëdha botërore u përfshi në një humbje të madhe ekonomike dhe njerëzore. Numri i viktimave ishte rreth 40 milionë të vrarë, ku gjysma ishin civilë. Shkaqet që çuan në këto luftura ishin të ndryshme si politike, ekonomike, fetare, raciale, territoriale, etj. Përpara një shkatërrimi të madh Europa u gjend në vështirësi të mëdha ekonomike, buqësia ishte shumë e rrënuar, lëndet e para dhe ushqimi mungonin.

Europa ishte e ngelur në udhëkryq, por çfarë politikash do të ndiqte Europa? Si mund të parandalohet një rikthim i konfliktit në Europë? Si mund të rilindë qytetërimi Evropian? E vetmja zgjidhje për Europën ishte bashkimi dhe integrimi i shteteve mes tyre.

Dy rrymat që ndikuan në integrimin evropian, janë federalizmi dhe e shteteve sovrane. Sipas rrymës federaliste, nëse Europa do të të bazohej në sistemin e kombeve-shtete, atëherë do të sillte konflikte dhe luftëra në të ardhmen, duke parë edhe të kaluarën e hidhur. Kështu që rryma federaliste propozonte një Europë të bashkuar e federale. Ndërsa rryma e shteteve sovrane theksonte se më e favorizuar për BE-në do të ishte ndërtimi apo rikthimi i saj mbi bazat e ekulibrit të kombeve-shteteve. Sips kësaj rryme kombe-shtetet e udhëhequra nga Britania ishte një formë shumë e mirë e përfaqësimit.

Në epokën aktuale, globalizimi është një tregues tepër i ndjeshëm. Sot me lindjen e një ekonomie botërore, të transportit dhe të teknologjisë globalizimi ka arritur që të bashkëpunojë ‘*për tej kufijeve*’ përmes transformimit të tij. Kështu që për sa i përket shtetit tradicional ai është në krizë nga transformimi global i ekonomisë politike ndërkombëtare.

Qëllimi i studimit:

Qëllimi i këtij punimi akademik është studiojë globalizimin nga një perspektivë ekonomike dhe evropiane. Efekti global sot është bërë i pa kontrolluar si në aspektin e kulturës, ashtu edhe në aspektin ekonomik. Nëse deri dje kombet-shtete ruanin formën e tyre të qeverisjes tradicionale dhe të sofistikuar, sot është e pamundur një izolim i tillë nga trysnitë e reja moderne si rasti në fjalë globalizimi.

Integrimi në Bashkimin Evropian dhe kryesisht për sa i përket pjesës Perëndimore të Ballkanit do të jetë në dobi të vetë organizatës unike të BE-së. Por pasi të jenë përmbushur kriterët e vendosur nga Bashkimi Evropian. Bashkimin Evropian mund ta shpëtojë vetëm integrimi dhe bashkëpunimi mes shteteve antarë.

Pyetja kërkimore:

Ky punim akademik zhvillohet mbi bazën e këtyre pyetjeve kërkimore dhe studimore të cilat janë:

1. Cili është roli i shtetit dhe i BE-së në epokën aktuale në ruajtjen e traditës nga transformimi global?
 - Dhe përgjigjet e këtyre pyetjeve të ngritura do të shtjellohen te *Hipoteza*.

Hipoteza:

Mbi pyetjet e ngritura më lartë rreth kërkimit të këtij punimi akademik, ato marrin përgjigje përmes një hipoteze se:

- Shtetet-kombet në ditët e sotme janë në krizë mund të themi për sa i përket fuqisë transformuese globale, në rastin evropian është suedia , gjermania etj., që ende në ditët e sotme i kanë bërë rezistencë globalizimit.

Metodologjia:

Metoda analitike e ndjekur është qasja konstruktiviste, nisur nga fakti se konstruktivizmi e sheh botën në optikën e ideve, kulturave, normave dhe të *perceptimit* të strukturës sociale që kemi krijuar në një kontekst të caktuar e mbi të gjitha rreth qenies ontologjike ku në qendër është individi. Formula dhe thënia më e famshme në qasjen konstruktiviste është “...*Politika ndërkombëtare është një ‘botë që e kemi krijuar ne.’*”⁵⁸. Konstruktivistët dallojnë thelbësisht nga realistët, që theksin e vinin te siguria e shtetit, e liberalët, në lirinë individuale, ndërsa konstruktivistët e vendosin theksin te **idetë** dhe **identiteti**. Konstruktivizmi përfshin studiues të ndryshëm, P. sh., Shpërbërja e Bashkimit Sovjetik , konstruktivistët e nënvizuan, interpretuan si “*mendimin e ri*”, kjo bëri që studiuesit që gjatë viteve ’90 të përqafonin interpretimin konstruktivist. I njëjti shembull vlen edhe për projektin e themelimit të Bashkimit Evropian, që u ngrit mbi bazat e ideve konstruktiviste.

Instrumentat e kërkimit:

Instrumentat e kërkimit për burimet e përpunuara janë literatura moderne, e-book (libra dixhital). Jam munduar të jem sa më koherent, i paanshëm dhe objektiv në përzgjedhjen e materialeve të literatures ku kam hulumtuar dhe klikuar në shumë burime të ndryshme si libri “*Dilemat e zhvillimit/modelet e zhvillimit ekonomik dhe social përballë globalizimit*” me autor Adrian Civici, botim i shtëpisë botuese “Geer”. Një tjetër libër i veçantë që më ka shërbyer në punimin tim akademik për të kuptuar integrimin ekonomik evropian, është ai me autorët Richad Baldwin dhe Charles Wyplosz “*Ekonomikësi i Integritimit Ekonomik Evropian*”, botim i shtëpisë botuese mediaprint. Gjithashtu pjesë e literaturës me rëndësi është edhe libri

⁵⁸ Për më shumë hollësi dhe argument rreth trajtimit të qasjes së konstruktivizmit e jo vetëm, shih Smith, S., Kurki, M. & Dunne T. (2010: 221-242). “*Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare/ disiplina dhe shumëllojshmëria.*” Tiranë: UETPRESS.

“Globalizimi dhe tranzicioni – dilemat dhe sfidat” me autor Selman Selmanaj, e të tjera burime hulumtuese.

Shteti tradicional dhe ideja e integritit Evropian

Po në ç'gjendje është katandisur Europa?... në tokat e saj të gjera sa të ha syri, mes rrënojave të qyteteve dhe shtëpive të dikurshme, turma të dërmuara e të uritura qeniesh njerëzore që me gojën hapur nga hutimi i plotë zhbirojnë horizontin e zymtë në pritje të ndonjë rreziku apo fushate të re territori... Kjo është ajo çka shtetet dhe kombet europiane morën në këmbim të luftës shkatërruese për jetë a vdekje me njëri-tjetrin.

Gjithësesi, ka një rrugë dalje. Duhet rikujtuar famlija europiane, ose diçka sa më e ngjashme me një organizim të tillë, që të sjellë paqe, siguri dhe demokraci për të gjithë. Ne duhet të ndërtojmë Shtetet e Bashkuara të Europës. – Winston Churchill (Zyrih, 19 shtator 1946).

Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore ishte një katastrofë për kontinentin evropian. Dëmet ishin të shumta e të pa llogaritshme si humbje jetë njerëzish, rënie ekonomike etj. Numri i këtyre viktimave arriti në 40 milionë të vrarë, ku më shumë se gjysma ishin civilë. Luftat ishin për shkaqe të ndryshme si fetare, raciale, politike, territoriale, etj. Europa u gjend përpara një shkatërrimi të madh, rrugët ishin të shkatërruara, buqësia e rrënuar, ndërkohë ushqimet dhe lëndet e para mungonin. Europa u gjend përballë tri çështjeve, e para ishte ekonomike: Si mund të rimëkëmbej europa? Ç'farë politikash duhet të ndiqte? E dyta: Ishte politike, sii mund të parandalohet një rikthim i konfliktit në Europë? Dhe e treta: Si mund të rilindej qytetërimi evropian pas këtij rrënimi? E vetmja zgjidhje për Europën për të dalë nga një krizë e tillë ekonomike, politike apo sociale, ishte pa dyshim bashkimi dhe integrimi i tyre në një famije të vetme. Ideja e integritit evropian erdhi nga dy baballarët e Integritit Evropian, i pari ishte biznesmeni francez Jean Monnet (1888-1979) dhe ministri i jashtëm francez Robert Schuman (1886-1963). (parë 12 mars 2015)⁵⁹. Jean Monnet ishte iniciatori dhe organizatori i Komunitetit Evropian të qymyrit dhe të hekurit. Ai kontribuoi me projektin e tij që Europën ta transformonte nga një vend i rrënuar në një tokë të paqës, lirisë dhe prosperitetit. Shumë nga idetë e tij janë në themelet e Bashkimit Evropian. Sipas Jean Monnet vendet e Europës janë të vogla e duhet doemos që të bashkohen dhe të integrohen për të zhvilluar ekonominë dhe mirëqenien e tyre, duke ndjekur një politikë të pëbashkët ekonomike. Ndërsa Schuman kishte në plan që të krijonte një Europë të fortë “nën kontrollin e një institucioni mbinacional”, edhe idetë e Schuman janë në themelet e Bashkimit Evropian, ku sipas tij kufijtë që i ndajnë shtetet-kombet nuk duhet të jenë pengesë ndërmjet popujëve dhe kulturave... kështu që duhet të i jepej

⁵⁹ <http://www.slideshare.net/madopol/15-pyetje-per-be-ne>

fund nocionit të “*armikut të trashëguar apo historik*” dhe se e ardhmja do të ishte që popujt të bashkohen dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. (Civici, A. 2007: 242-244).

Kjo do të arrihej përmes një tregu të përbashkët që do të krijohet në vitin 1957 nga Traktati i Romës, duke plotësuar bashkimin doganor, me lëvizjen e lirë të mallrave, të shëbimeve, të punëtorëve dhe kapitaleve. (d’Arcy, F., 2007: 16-17). Trakti i Romës dhe i akt marrëveshjeve të tjera që do të vijonin më pas, ishin një pikënisje për suksesin europian në rimëkëmbjen ekonomike të saj.

Dy rryma që kanë ndikuar në integrimin europian janë: rryma federaliste dhe ajo e shteteve sovraane. Sipas rrymës **federaliste**, nëse sistemi europian i ngritur mbi bazat e sovraniteti kombëtar dhe të kombeve-shtete do të sillte në të ardhmen luftra. Kjo një përvojë për vendet europiane që gjithmonë kanë qenë të përfshiura në konflikte dhe luftra për interesa të ndryshme, si fetare, territoriale etj. Një integrim i formës federale do ta shpëtonte europën nga krizat apo lufta të ndryshme që mund të haste. Gjitashtu shpenzimet për armatime apo fuqizime është bërë e pa përballueshme dhe një bashkëpunim mes shteteve europiane do të ulte kostat për fuqizime dhe sigurisht në aspektin e integrimin ekonomik do të kishte pasoja shumë pozitive. Një tjetër rrymë është ajo e **shteteve sovraane**, sipas tyre kombet-shtetet e udhëhequra nga Britania, ishte një formë shumë e mirë e përfaqësimit. Ato mendonin se integrimi ekonomik europian duhet të ishte vetëm në aspektin ekonomik dhe kompetencat të mbeteshin në duart e qeverive me një qeverisje unanime.

Por të dyja rrymat kishin bazat dhe mbështetjet e tyre të argumentimit, p.sh grupi që ishte për qeverisje federaliste në fakt kishte një mbështetje prej shteteve të humbuara si Belgjika, Holanda, Luksemburgu, Franca Austria, Gjermania dhe Italia. I tillë vlen edhe për rrymën e shteteve sovraane, ku qeveritë ishin të sofistikuara për të shmangur pushtimin e huaj apo humbjet e larta në jetën njerëzore. Këtu mund të klasifikohen vende si Mbretëria e Bashkuar, Danimarka, Norvegjia etj. (Baldwin, R., & Wyplosz Ch., : 10-11)

Përkufizimi dhe koncepti mbi Globalizimin

Koha në të cilën jetojmë aktualisht, është koha e transformimit global, ku të drejtat dhe liritë e njeriut dominojnë. Në këtë kohë ku shtetet-kombe janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën përmes korporatave multinacionale dhe të rrejtit ndërkombëtar financiar.

Me globalizim nënkuptojmë shndërrimin e ekonomive nacionale në ekonomi globale, botërore. Instrumentat nëpër të cilën kalon ky proces janë:

- a) rregullimi i ekonomisë
- b) liberalizimi, si dhe
- c) privatizimi i saj.

Globalizimi si proces ekonomik dhe kulturor, mund ta trajtojmë si ndërlidhshmëria reciproke mes njerëzve për bashkëpunuar dhe zhvilluar qytetërimet e tyre. Kështu që globalizimin mund ta përkufizojmë si **një integrim të shpejtë të njerëzimit me një lëvizje dhe transformim të pa parë të kapitalit, teknologjisë së komunikimit, ideve dhe vlerave kulturore midis shteteve dhe popujve.** (Selmanaj, S. 2006: 11-12).

Globalizimi me efektet e tij që sot po i ndjejmë dhe i komentojmë çdo ditë, është para se gjithash si pasojë e revolucionit të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit. Gjithashtu edhe si pjesë e sistemit liberal ekonomik me shkëmbimet ndërkombëtare tregtare në kuadrin e OBT-së apo marrëveshjeve rajonale të kontinenteve të ndryshme të botës. Rritja e konkurrencës në ditët e sotme aktuale është në shkallë ndërkombëtare më e lartë se në kohën klasike. Ekonomia e re apo “net-ekonomia” po bëhet gjithnjë një realitet imponues. Sfidat tashmë nuk janë vetëm në Europë, por në tërë globlin, kështu si pasojë e këtij “revolucionit të tretë teknologjik”, ku të gjithë shtetët mund të ndeshën me njëra-tjetrën. (Civici, A. 2007: 34-35).

Globalizimi si proces mund të dallohet në tre nivele të tij:

- a) ekonomik,
- b) politik, si dhe
- c) kulturor-ideologjik. (Selmanaj, S. 2006: 21).

Globalizimi dhe sfidat e BE-së

“Revolucioni europian i epkës sonë synon të zëvendësojë rivalitetet nacionale me një bashkim të popujve në liri dhe diversitet...ai synon një hapsirë të re për civilizimin dhe kulturën tonë...është një “renaissance” e re europiane”, “le të vazhdojmë pra...pasi për popujt europianë nuk ka asnjë të ardhme tjetër veç bashkimit”, “njerëzit janë të nevojshëm për të bërë të mundur ndryshimet...por janë institucionet ato që i japin jetë këtyre ndryshimeve...le të përpiqemi t’i modernizojmë vazhdimisht ato”. – **Jean Monnet**

Sot kombet-shtetet janë shumë të ndërvarura me njëri-tjetrin dhe presioni global është prezentë përmes bashkëpunimit ekonomik për tej kufijeve. Sot globalizimi ka prodhuar lindjen e një ekonomie të botërore dhe sistemet e transportit, të teknologjisë së informacionit kanë mundësuar të kemi një bashkëpunim për tej kufijeve. Kjo mund shihet si një krizë për

sovrانيتin e sotëm jo vetëm në Europë por kudo në arenën ndërkombëtare. Sot me një shoqëri të hapur dhe me shtete të integruara, elitat politike koordinojnë një grup rregullash të cilat do të mundësojnë sjelljen e tyre në përputhje me epokën aktuale. (Smith, S., Kurki, M. & Dunne T., 2010: 346). Sovraniteti shtetëror në epokën aktualë është pak i rëndësishëm për klimën globale. Nevoja për bashkëpunim mes shteteve do të sjellë që këta aktorë të hartojnë politika të ndryshme në shërbim të interesit publik.

I vetëmi shtet në europe që i ka bërë rezistence presionit global është Suedia, një shtet i cili edhe në ditët e sotme ka arritur të ruajë traditën e tij përmes politikave sociale. Kjo në shërbim të publikut, kështu që shteti Suedez ndjek politika sociale ose e thënë ndryshe i kushton tepër rëndësi shtresës sociale apo grupeve në nevojë. Me politikat sociale Suedia ka bërë që arsimi të jetë falas, shërbimi shëndetësor deri në një farë tarife (hyrje) është i lirë për të gjithë suedezët, në rastin e papunësisë paguhen rreth 80% të pagës së mëparshme deri në një kufi maksimal. Suedia që pas viteve '20 do të përqaftonte vlerat e demokracisë sociale dhe do të kishte një progres ekonomik social. Arsimi në Suedi është falas dhe shërbimi shëndetësor vlerësohet në maksimal. Suedia ishte vetëm një rast, i tillë është rasti edhe për sistemin politik Gjerman. Gjermania ndjek të njëjtën strukturë për sa i përket politikave sociale si arsimi, shërbimi shëndetësor, etj. (Gombert, T. 2009: 142). Johannes Vogel, zëdhënës për politikën e tregut të punës në Gjermani, në një rast duke folur për një raport të varfërisë, theksoi se gjermania ka më pak të pa punë dhe shkallën më të ulët të papunësisë në të gjithë Europën dhe sektori i pagave minimale është tkurrur. (parë 6 mars 2014) ⁶⁰.

Shteti me gjithë karakterin e tij tradicional dhe centralizues, po përballet me një sërë sfidash për shkak të procesit global dhe lëvizjeve ndërkombëtare, qofshin këto fetare apo ideologjike, si edhe lëvizjet etnonacionaliste. (Mingst, K., A.,: 2010:169). Nëse shtetet nuk ndjekin një politikë të ekuilibruar dhe sociale, atëherë pa barazia do të jetë me pasoja të larta. Megjithatë kjo pabarazi është e theksuar më së shumti në Jug ndaj Veriut, e cili vazhdimisht është dhe vazhdon të pasurohet. Kjo fuqi kapitale dhe globale, ka arritur fuqinë e kapitalit në krahasim me shtetin. (Smith, S., Kurki, M. & Dunne T., 2010: 343). Globalizimi, ashtu sic ka edhe anët negative, ka edhe anët pozitive si bashkëpunimi mes shteteve. Rasti i BE-së me shtetet e Bashkuara të Amerikës është një shembull suksesi përse i përket bashkëpunimit ekonomik. Jo vetëm ekonomik por SHBA-ja është një partner i fortë për BE-në, sepse Shtetet e Bashkuara të

⁶⁰ <http://www.dw.de/debati-p%C3%ABr-raportin-mbi-varf%C3%ABrin%C3%AB-n%C3%AB-gjermani/a-16652598>

Amerikës në mënyrë të vazhdueshme kanë mbështetur integrimin europian, kjo më së shumti në rastin e mbështetjes strategjike. (Dinan, D.: 331).

Fracis Fukuyama theksonte se globalizimi duhet të shihet si një fakt i pandalshëm i jetës me sfidat e tij post-moderne dhe me një mundësi që të kontrollohet me kujdes nën instrumentin e politikës. (parë 6 mars 2015)⁶¹. Forcat globaliste, si politike, ekonomike dhe kulturore, dobësojnë sovranitetin shtetëror; ndërhyjnë në ushtrimin e fuqisë shtetërore në ekonomi, politike dhe kulturë. (Mingst, K., A.,: 2010: 170). Disa nga treguesit e globalizimit janë kur kemi flukes ndërkuftare të mallrave, të investimeve dhe informacionit. Ndërvarësia mes shteteve. përhapja e problemeve si ekonomike, siguria kombëtare, si dhe përhapja e zhvillimi i institucioneve të ngarkuara me përgjegjësi për hartimin e politikave globale. (Smith, S., Kurki, M. & Dunne T., 2010: 348).

Në BE janë tashme tre modele sociale kushtet aktuale të evolucionit dhe përsa i përket efekteve të globalizimit, duke u përshtatur me kushtet e reja të kohës, të cilat janë:

1) regjimi liberal ‘anglo-saksion’

Të frymëzuar nga eksperiencat e Clinton, laburistët me sukses kanë synuar të bëjnë për vete ‘Middle England’ ose klasën e mesme, në garantimin e mbijetës së binomit ‘efikasitet ekonomik – barazi sociale.’

2) sistemi ‘konservator-korporatist’ francez, si dhe

Pas Luftës së Dytë Botërore, modeli social francez bëri një reformë ekonomike në ndërhyrjen e fortë shtetërore, ku shtresat sociale ishin në fokus si paga minimale e garantuar, sigurime sociale për të papunët, mbulim i sigurimeve sociale për pensionistët etj.

3) regjimi ‘social-demokrat’ skandinav.

Me rritjen e procesit të globalizimit ekonomik, strategjia ishte ‘New labor’, e profilizuar si ‘pro-biznes’, ku në thelb ka përpjekjen për të garantuar rritjen ekonomike të qëndrueshme, e duke u marrë njëkohësisht edhe me problemet sociale. (Civici, A. 2007: 87-90).

Në lidhje me globalizimin dhe transformimin e tij ekonomik, politik dhe kulturor, ekonomistët i kanë shqetësuar dy parashikime që janë sipas tyre:

⁶¹ <http://www.tiranaobserver.al/globalizmi-mireqenia-dhe-manifesti-i-marketingut-global/>

1. Në një treg financiar global e më të integruar përqindjet e interesit duhet të konvergojnë me një treg financiar botëror të integruar dhe duke eliminuar ndryshimet në përqindjet e interesit, si dhe
2. Duhet të zvogëlohet sipas tyre korelacioni midis kursimeve të brendshme dhe investimeve, ndërsa përse i përket tregut kapital, ai duhet të bjerë zero – si vazhdim i korelacionit kurisime/investime që mund të shihet si një tregues i mungesës së integritit të tregut financiar. (Smith, S., Kurki, M. & Dunne T., 2010: 355).

Sipas Peter Mandelson efektet ekonomike të globalizimit janë ndjerë për dekada në Europë, duke qenë se kemi një presion mbi biznesin, një rënie ekonomike në prodhim dhe një presion të qëndrueshëm mbi cmimet e importit. (parë 6 mars 2015)⁶²

Konkluzione

Në përfundim të këtij punimi akademik mund të arrijmë në disa konkluzione. Mësuam se Dy lufërat e Mëdha Botërore e përkeqësuan shumë ekonominë Europiane dhe duhej doemos një ndryshim i menjëhershëm konstruktiv për të ardhmen Europiane. Ajo u gjend përpara tre pyetjeve: Si mund të rimëkëmbej ekonomia? Si mund të parandalohej edhe një rikthim i konflikti, lufte në të ardhmen? Dhe, si mund të rilindej ekonomia evropiane? Dhe e ideja e Bashkimit European u realizua nga dy projektuesit e mëdhenj si Jean Monnet dhe Robert Schuman.

Për sa i përket globalizimit ekonomik ai si një proces dhe me transformime globale dhe është bërë pjesë e jetës tonë të përditshme në temat e diskutimit. Si një forcë ekonomike, politike dhe kulturore *‘për tej kufijeve’* ai dominon globin në epokën aktuale. Pavarësisht ndikimit global dhe përpjekjes së shtetit tradicional për rezistencë, ende në Bashkimin European kemi kemi shtete të forta që janë rezistentë ndaj globalizimit. Duke ndjekur politikat sociale të ekuilibruara për një stabilitet të qëndrueshëm ekonomik, vende të tilla si Suedia, Gjermania, Britania, Franca etj.

⁶² <http://www.spiegel.de/international/eworld/opinion-globalization-is-good-for-europe-a-590166.html>

Globalizimi ashtu siç ka edhe anët negative, duhet pranuar edhe anët e tij pozitive si investimi, transporti, teknologjia informative, etj., për një rend të qëndrueshëm dhe për një stabilitet ekonomik, juridik dhe politik.

Bibliografia:

Baldwin, R., & Wyplosz Ch. *Ekonomiksi i Integritimit Evropian*. Tiranë: Mediaprint

Civici, A. (2007). *Dilemat e zhvillimit/modelet e zhvillimit ekonomik dhe social përballë globalizimit*. Tiranë: “Geer”

D’Arcy, F. (2007). *Politikat e Bashkimit Evropian*. Tiranë: Papirus

Dinan, D. *Politikat e Bashkimit Evropian*. Tiranë: AIIS

Gombert, T. (2009). *Bazat e Demokracisë Sociale*. Tiranë: FRIEDERICH EBERT STIFTUNG

Karen, A., K. (2010). *Bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare*. Tiranë: AIIS

Smith, S., Kurki, M. & Dunne T. (2010). *Teoritë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare/ disiplina dhe shumëllojshmëria*. Tiranë: UETPRESS

Selmanaj, S. (2006). *Globalizimi dhe tranzicioni – dilemat dhe sfidat*. Prishtinë: RIINVEST

<http://www.slideshare.net/madopol/15-pyetje-per-be-ne>

Burime nga interneti

<http://www.dw.de/vler%C3%ABsime-dhe-kritika-p%C3%ABr-globalizimin/a-2588226> (parë 6 mars, 2015)

<http://www.spiegel.de/international/world/opinion-globalization-is-good-for-europe-a-590166.html> (parë 6 mars 2015)

<http://www.dw.de/debati-p%C3%ABr-raportin-mbi-varf%C3%ABrin%C3%AB-n%C3%AB-gjermani/a-16652598> (parë 6 mars 2015)

<http://www.tiranaobserver.al/globalizmi-mireqenia-dhe-manifesti-i-marketingut-global/> (parë 6 mars, 2015)